



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1557/1 Prot

Tiranë, më 04.11.2019

V E N D I M

Nr.109, datë 04.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Kavajë të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kavajë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Kavajë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Kavajë, me Vendimin nr. 131, datë 26.12.2019, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kavajë dhe njësive administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Kavajë, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka nxjerrë vendimin nr. 01, datë 03.01.2019, “Për miratimin e strukture organizative të Bashkisë Kavajë për vitin 2019”. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Kavajë së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **106** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion të kategorisë së lartë drejtuese; **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese; **22** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **73** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **49** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrencës të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **50** pozicione të shërbimit civil, rezulton se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jospas një procedure konkurrencë të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **7** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakant.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, Përgjegjës në Sektorin e Hartografisë, Regjistrimit të Pronave të Bashkisë, Kadastrës dhe GIS, Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 190, dt. 04.08.2017;
2. *****, Specialist Agronom në Sektorin e Hartografisë, Regjistrimit të Pronave të Bashkisë, Kadastrës dhe GIS, Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 79, dt. 06.03.2018;
3. *****, Specialist i Mirëmbajtjes së Tokave në Njësinë Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 678, dt. 30.11.2017;
4. *****, Specialist i Strehimit në Sektorin e Strehimit, Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 41, dt. 07.09.2017;

5. *****, Përgjegjëse në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 359, dt. 07.09.2017;
6. *****, Specialiste e Marrëdhënieve me Publikun në Njësine Administrative Golem emëruar me aktin nr. 53, dhe aktin nr. 53/1, dt. 15.04.2019;
7. *****, Specialist i Marrëdhënieve me Publikun në Njësine Administrative Synej, emëruar me aktin nr. 11, dt. 22.01.2019;
8. *****, Specialiste e Marrëdhënieve me Publikun në Njësine Administrative Luz i Vogël, emëruar me aktin nr. 505, dt. 15.09.2017;
9. *****, Përgjegjës në Sektorin Juridik, Drejtoria Ligjore, emëruar me aktin nr. 686, dt. 04.12.2017;
10. *****, Specialist Protokoll-Arkivi në Njësine Administrative Helmes, emëruar me aktin nr. 468, dt. 12.09.2017;
11. *****, Specialiste IT në Sektorin e Protokollit, Arkivës dhe TIK, Drejtoria Ligjore, emëruar me aktin nr. 142, dt. 12.06.2018;
12. *****, Specialist në Njësine e Auditimit të Brendshëm, emëruar me aktin nr. 377, dt. 05.09.2017;
13. *****, Drejtore në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike, emëruar me aktin nr. 175, dt. 30.09.2019;
14. *****, Përgjegjëse në Sektorin e Buxhetit dhe Kontabilitetit Financiar, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, emëruar me aktin nr. 225, dt. 17.08.2017;
15. *****, Specialiste në Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 184, dt. 02.10.2018;
16. *****, Specialiste Ekonomiste-Arkëtare, Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 06, dt. 11.01.2019;
17. *****, Specialist Inxhinier në Sektorin e Blerjeve dhe Prokurimeve Publike, emëruar me aktin nr. 206, dt. 14.08.2017;
18. *****, Specialiste Ekonomiste në Sektorin e Blerjeve dhe Prokurimeve Publike, emëruar me aktin nr. 614, dt. 12.10.2017;
19. *****, Drejtore në Drejtorinë Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr. 103, dt. 28.08.2019;
20. *****, Specialist Tatim-Taksa, Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 188, dt. 11.10.2018;
21. *****, Specialist Tatim-Taksa, Njësia Administrative Synej, emëruar me aktin nr. 674, dt. 30.11.2017;
22. *****, Përgjegjës në Sektorin e Task Forcës dhe Verifikimit në Terren, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr. 198, dt. 07.08.2017;
23. *****, Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit të Ardhurave, Mbledhjes së Borxhit, Rakordimit të Taksave dhe Apelit, Drejtoria e të Ardhurave dhe Menaxhimit të Borxhit, emëruar me aktin nr. 640, dt. 26.10.2017;

24. *****, Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 582, dt.02.10.2017;
25. *****, Përgjegjës në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 19, dt.08.02.2019;
26. *****, Specialist i Ndikimit dhe Monitorimit të Mjedisit në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 155, dt.11.07.2018;
27. *****, Specialist Veteriner në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 226, dt.17.08.2018;
28. *****, Specialist i Ushqimit në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 16, dt.06.02.2018;
29. *****, Specialist i Ushqimit në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mjedisit, emëruar me aktin nr. 18, dt.06.02.2018;
30. *****, Specialist Veteriner Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 125, dt.17.05.2018;
31. *****, Specialiste Juriste, Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 126, dt.17.05.2018;
32. *****, Specialist Agronom, Njësia Administrative Synej emëruar më dt.26.04.2019;
33. *****, Specialist Veteriner, Njësia Administrative Synej, emëruar me aktin nr. 675, dt.30.11.2017;
34. *****, Specialist Veteriner, Njësia Administrative Luz i Vogël emëruar me aktin nr. 507, dt.15.09.2017;
35. *****, Jurist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 38, dt.05.09.2017;
36. *****, Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Shërbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr.212, dt.15.08.2017;
37. *****, Specialist Infrastruktura në Sektorin e Menaxhimit të Transportit, Trafikut dhe Parkimit Publik, Drejtoria e Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 595, dt.04.10.2017;
38. *****, Specialist Shërbimesh, Njësia Administrative Golem, emëruar me aktin nr. 97, dt.20.08.2019;
39. *****, Specialist Inxhinier në Sektorin e Zhvillimit të Territorit, Lejeve Zhvillimore, Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 392, dt. 06.09.2017;
40. *****, Specialist Inxhinier Elektrik në Sektorin e Zhvillimit të Territorit, Lejeve Zhvillimore, Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr.104, dt.28.08.2019;

41. *****, Specialiste Juriste në Sektorin e Zhvillimit të Territorit, Lejeve Zhvillimore, Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, emëruar me aktin nr. 553, dt.25.09.2017;
42. *****, Përgjegjëse në Sektorin e Projektimit dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja emëruar me aktin nr. 563, dt.27.09.2017;
43. *****, Specialist Arkitekt i Lartë në Sektorin e Projektimit dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja, emëruar me aktin nr. 48, dt.23.07.2017;
44. *****, Specialist Arkitekt i Lartë në Sektorin e Projektimit dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja, emëruar me aktin nr. 232, dt.17.08.2017;
45. *****, Specialist Inxhinier në Sektorin e Projektimit dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Projektimit, Politikave Zhvillimore dhe Investimeve të Huaja, emëruar me aktin nr.612, dt.12.10.2017;
46. *****, Përgjegjës në Sektorin e Emergjencave Civile, Uljes së Rrezikut nga Katastrofat Përmbytjet, Koordinimit me Aktorët, emëruar me aktin nr. 469, dt. 11.09.2017;
47. *****, Specialist në Sektorin e Emergjencave Civile, Uljes së Rrezikut nga Katastrofat Përmbytjet, Koordinimit me Aktorët, emëruar me aktin nr. 583, dt. 02.10.2017;
48. *****, Përgjegjës në Sektorin e Shumë Sporteve, Drejtoria e Kulturës, emëruar me aktin nr. 372, datë 04.09.2017;
49. *****, Përgjegjëse në Sektorin e Buxhetit dhe Kontabilitetit Financiar, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, emëruar me aktin nr. 68, dt. 26.02.2018;
50. *****, Specialiste e Marrdhënieve me Publikun, Njësia Administrative Synej, emëruar me aktin nr. 211, dt. 07.12.2018.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Kavajë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Gjatë verifikimit në këtë institucion, rezulton se, punonjësit në pozicione të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese (përgjegjës sektori/drejtor drejtorie), ***** dhe ***** të cilët aktualisht kryejnë detyrat në pozicionet e punës “Përgjegjës Sektori” zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional”.

Nga dokumentacioni i administruar nuk mund të arrijmë në një konkluzion të qartë nëse këta punonjës i përmbushin kriteret ligjore për një Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.

Në këtë rast njësia përgjegjëse, të verifikojë nëse plotësohen kushtet e parashikuara në aktin nënligjor në fjalë, për rastin e Masterit profesional ku janë diplomuar nëpunësit dhe të njoftojë Komisionerin për rezultatet në përfundim të procesit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **50** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi dhe të rregullojë pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, me qëllim që të plotësohen në përputhje me ligjin.
2. Njësia përgjegjëse të verifikojë faktin nëse punonjësit Ismail Broli dhe Marjus Habili i plotësojnë kushtet e posaçme në rastin e Masterit profesional (*120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike*) dhe të njoftojë Komisionerin për rezultatet në përfundim të procesit.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.
4. Njësia përgjegjësetë vijoje realizimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet e lira, duke aplikuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit.
5. Institucioni tëpërgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në

vendimin nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

6. Të përmbyllen proceset e mbikëqyrjes të cilët kanë përfunduar me vendimet paralajmëruese nr. 74, datë 29.06.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë” dhe nr. 71, datë 06.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr. 30, datë 10.02.2017” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kavajë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Ministria e Brendshme. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kavajë duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha